

VENDIM
Nr.771, datë 9.11.2006

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË
PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I LINJËS 110 KV,
KUÇOVË-BERAT-UZNOVË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 1, 20 e 21 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i linjës 110 kv, Kuçovë-Berat-Uznovë, sipas tabelës, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Shpronësimi të bëhet në favor të KESH sh.a.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme që shpronësohen, të kompensohen në lekë, në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën, e cila i bashkëlidhet këtij vendimi, për sipërfaqen 4 696 m² tokë bujqësore/arë, vlerësuar në shumën e përgjithshme 5 129 580 (pesë milionë e njëqind e njëzet e nëntë mijë e pesëqind e tetëdhjetë) lekë.

4. Ky fond të përballohet nga fondet e KESH sh.a., zëri “Kosto vendore për shpronësimet”.

5. Vlera e shpenzimeve procedurale të shpronësimit, në shumën 480 000 (katërqind e tetëdhjetë mijë) lekë, të përballohet nga KESH sh.a., si subjekti kërkues i këtij shpronësimi.

6. Shpronësimi të fillojë brenda muajit nëntor 2006 dhe të përfundojë brenda muajit dhjetor 2006.

7. Punimet për ndërtimin e kësaj linje kanë filluar në tetor 2005 dhe kanë përfunduar në tetor 2006.

8. Ngarkohen Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe KESH sh.a. për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha





